UDHËZIM
Nr. 24, datë 14.9.2012

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 45, DATË 19.12.2011 "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pas shtojcës nr. 3 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar, shtohet shtojca nr. 4 "Të dhënat e regjistrit bazë", bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj